

IN MEMORIAM

PROF. DR. XHELADIN SHALA
(1949 – 2022)



Pa u mbushur një vit, Instituti Albanologjik u ballafaqua sërish me vdekje. Pas humbjes, së Prof. dr. Sadri Fetiut, shkencëtarit shumë të çmuar dhe drejtuesit të Institutit Albanologjik, erdhi lajmi tjetër i kobshëm se u nda nga jeta punonjësi shumëvjeçar i Institutit Albanologjik Prof. dr. Xheladin Shala. Kjo ngjarje e hidhur dhe krejt e papritur ka tronditur thellë familjen dhe gjithë kolegët e shokët e tij të shumtë. Prof. dr. Xheladin Shala u lind më 3 gusht 1949 në Mushtisht. Shkollën fillore e kreu në vendlindje (1966), gjimnazin në Prizren më 1970, ndërsa diplomoi më 1974 në Fakultetin Filozofik, Dega e Historisë në Prishtinë. Dy vjet (1974-1976) punoi si profesor i lëndës së historisë në Gjimnazin e Therandës. Studimet pasuniversitare i kreu gjatë viteve 1975-1977. Nga shtatori i vitit 1977 e deri në vitin 2014 punoi në

Institutin Albanologjik, në Degën e Historisë. Temën e magistraturës me titullin “*Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1918-1924*” e mbrojti më 1979. Gjatë viteve 1977-1980 ishte kryetar i Pleqësisë së Institutit Albanologjik. Dy mandate ishte shef i Degës së Historisë 1980-1984. Në vitin 1986 e mbrojti tezën e doktoratës me titullin “*Marrëdhëniet shqiptaro-serbe 1912-1918*”. Në fushë të dijes historiografike, prof. dr. Xheladin Shala u bë emër i mirënjohur me shkrime të guximshme të mbështetura në faktografi burimore. Ai ka botuar rreth 2000 faqe tekst në revistat më të njohura shkencore. Ka marrë pjesë në dhjetëra tryeza, tribuna, sesione, simpoziume, konferenca dhe kongrese shkencore të organizuara në Republikën e Kosovës dhe jashtë saj. Përpos këtyre shkrimeve, Prof. Xheladin Shala i botoi edhe këto vepra: “Marrëdhëniet shqiptaro-serbe 1912-1918”, PR, 1989; “Çështja shqiptare dhe diplomacia serbe 1912-1913”, PR, 2006; “Ngjarje dhe personalitete historike”, 2009; “Pushtimi i Kosovës nga Serbia dhe Mali i Zi”, Prishtinë, 2012; Hasan Prishtina-vështrim i shkurtër, Prishtinë, 2014, “Kontribute për 100-vjetorin e pavarësisë”, 2015 dhe vepra e tij e fundit u botua me 2017 me titullin “Shqipëria në Konferencën e Ambasadorëve 1912-1913”. Prof. Xheladin Shala punoi rreth dyzet vjet në Institutin Albanologjik. Ai me punën e vet të pandërprerë shkencore, e afirmoi këtë institucion në rrafshin e historisë sonë kombëtare dhe asaj ndërkombëtare. Mbi bazën e analizave shkencore dhe, duke mbajtur qëndrim kritik ndaj ngjarjeve të viteve të fushës së interesimit, Prof. Shala bëri shpjegimin historik të dokumenteve, punë që dëshmohet me anë të dokumenteve, duke demaskuar dhe duke hedhur poshtë si pseudoshkencë, pikëpamjet dhe qëndrimet e historiografisë ekspansioniste serbosllave, lidhur me Shqipërinë Etnike të këtyre viteve. Përmes studime të tij shkencore ai jo vetëm që ringjalli historinë tonë, por edhe ndriçoi të vërtetën historike e cila shpeshherë është nëpërkëmbur edhe për qëllime jo vetëm shkencore. Pra, mund të thuhet lirisht se Prof. Xheladin Shala, jo rrallëherë, ishte edhe një mburojë e pathyeshme shkencore ndaj të gjithë atyre pseudoshkencëtarëve, qofshin ata të huaj apo shqiptarë, të cilët për qëllime të ndryshme politike dhe jo vetëm aq, donin ta mohonin dhe ta denigronin. Në saje të punës dhe falë aftësive të tij organizative, Xheladin Shalës në Institutin Albanologjik iu besuan edhe detyra me rëndësi shkencore e organizative: shtatë vjet (1978-1985) ishte sekretar i redaksisë së revistës “Gjurmime albanologjike” – Seria e shkencave historike, ndërsa nga viti 1986 e deri 2012 ishte Kryeredaktor i revistës “Gjurmime albanologjike” - Seria e shkencave historike, duke përgatitur kështu pandërprerë 26 numra të saj. Prof.dr. Xheladin Shala ka qenë edhe

mentor dhe anëtar i disa komisioneve në mbrojtjen e magistraturave dhe doktoratave. Gjithashtu, ishte redaktor dhe recensent i disa dhjetëra veprave historike, duke iu përmbajtur rigorozisht etikës shkencore për vlera të mirëfillta. Vdekja e tij, përveçse humbje e madhe për familjen, gjithashtu lë një zbrazëti të veçantë edhe në historiografinë dhe në kulturën shqiptare përgjithësisht.

Ai ishte dhe mbetet një autoritet në fushën e historiografisë, përkrah figurave të shquara në Kosovë dhe Shqipëri.

Prof. dr. Lulëzim LAJÇI

